

**July 19**

*Pyetje – Përgjigje*

**2018**

*Programet financuese të BE-së për SME-të, Pronësia  
Industriale dhe e Drejta e Autorit*

**Horizon 2020  
SME Instrument**

## Pyetje – Përgjigjet për/nga DPPI.

*1. Cila është baza ligjore në fuqi (ligjet) dhe aktet nënligjore që rregullojnë marrëdhënien mes kërkuesit shkencor e institucionit që i financon punën kërkimore lidhur me produktin e tij kërkimor që mund të kthehet në patentim shpikje, inovacion, transferim teknologjie?*

Ligjet e patentave:

- Ligji Nr. 9947, datë 07.07.2008 "Për Pronësinë Industriale", i ndryshuar;
- VKM-së Nr 1707 datë 29.12.2008 për Miratimin e rregullores "Për lëshimin e Patentave për Shpikje dhe Modelet e përdorimit" e ndryshuar;
- VENDIM Nr.883, datë 13.5.2009 "Për miratimin e tarifave për regjistrimin e objekteve të pronësisë industriale", i ndryshuar;
- Ligji Nr.8488, datë 13.5.1999 "Për mbrojtjen e topografisë së qarqeve të integruara" i ndryshuar.

*1.1 Cfarë përcaktimesh , klasifikimesh ka legjislacioni shqiptar mbi pronësinë intelektuale për termat patentë, shpikje, inovacion, transferim teknologjie, start up.*

DPPI është i vetmi institucion në vend i cili lëshon certifikatat e pronësisë për patentat për shpikje në Shqipëri.

Patenta jepet për produkte apo proçese të cilat plotësojnë kushtet e mëposhtme:

- 1- të përbëjë risi (nuk është pjesë e arritjeve të mëparshme)
2. të përmbajë hap shpikës
- 3 të jenë të zbatueshme në industri apo bujqësi .
4. Objekti i shpikjes, që mbrohet nga një patentë, mund të jetë një produkt ose një proçes.
5. Shpikjet bioteknologjike janë të patentueshme, nëse kanë të bëjnë me:
  - a) material biologjik, që merret ose izolohet nga mjedisi i tij natyror, apo që prodhohet me anën e një proçesi teknik, edhe nëse ka ndodhur më parë në natyrë;
  - b) bimët ose kafshët, nëse mundësia teknike e shpikjes nuk kufizohet në një varietet të veçantë bimor apo shtazor;
  - c) një proçes mikrobiologjik ose proçes tjetër teknik apo një produkt i përfutur nëpërmjet një proçesi të tillë, me përjashtim të rastit kur përfitohet një varietet bimor apo shtazor;
  - ç) një element i marrë apo i izoluar nga trupi i njeriut ose i prodhuar ndryshe, nëpërmjet një proçesi teknik, duke përfshirë një sekuencë apo një sekuencë të pjeshme të një gjeni, mund të përbëjë shpikje të patentueshme, edhe nëse struktura e tij është identike me strukturën e elementit natyral. Aplikimi industrial i sekuencës ose i sekuencës së

pjeshme të një gjeni duhet të bëhen publikë në aplikimin për patentë.

Per tu pajisuar me nje patente per shpikje duhet të aplikoni pranë DPPI-së.

*1.1. Cfarë procedure ndiqet nga kërkuesi, grupi i kërkuesve në bazë të legjislacionit shqiptar për të regjistruar si patent, shpikje apo inovacion teknologjik një produkt të caktuar si rezultat i punës kërkimore.*

Aplikimi për lëshimin e një patente bëhet nëpërmjet formularit të aplikimit të paraqitur nga DPPM në faqen e zyrës [www.pppm.gov.al](http://www.pppm.gov.al), i cili nënshkruhet nga aplikanti ose përfaqësuesi i tij dhe depozitohet pranë protokollit të DPPI.

1. Aplikimi për patentë duhet të përmbajë:

- a) një kërkesë për dhënien e patentës (formularin FP1);
- b) një përshkrim të shpikjes;
- c) një ose disa pretendime;
- ç) vizatimet, të përmendura në përshkrimin ose në pretendimet;
- d) një abstrakt (përmbledhja e shpikjes);
- dh) dokumentin e prioritetit, nëse pretendohet për prioritet.

2. Aplikimi përmban emrin e shpikësit ose, kur janë disa, emrat e të gjithë shpikësve. Nëse aplikanti nuk është shpikësi ose nuk është njëri prej shpikësve, aplikimi duhet të përmbajë një deklaratë, që tregon origjinën e së drejtës për patentë.

3. Aplikimi shoqërohet me pagesën e tarifave të caktuara.

*1.2. Si ndahet në bazë të legjislacionit shqiptar pjesa e së drejtës së autorit e fitimit të mundshëm mbi një product kërkimor që mund të bëhet i tregtueshëm ( shpikje, patent, inovacion, transferim teknologjie, krijim start up) mes studiuësit dhe institucionit që ka financuar punën e tij kërkimore .*

Tek patentat për shpikje sipas Nenit 15 të Ligjit të Pronësisë Industriale.

Neni 15 Shpikja nga një punëmarrës:

1. Nëse një shpikje është bërë në kuadër të një kontrate ose marrëveshjeje pune:

- a) e drejta për patentë i përket personit, që porositi kryerjen e saj ose punëdhënësit, përveç kur parashikohet ndryshe në kontratë;
- b) kur shpikja ka një vlerë ekonomike shumë më të lartë nga ajo, që palët kishin parashikuar në kohën e nënshkrimit të kontratës së punës, punëmarrësi ka të drejtën e një kompensimi të veçantë. Në mungesë të marrëveshjes ndërmjet palëve për vlerën e kompensimit, kjo vendoset nga gjykata.

2. Kur një punëmarrës, edhe pse kontrata e punës nuk e detyron të merret me veprimtari shpikëse, bën një shpikje, duke përdorur të dhëna dhe mjete të tjera, që i bëhen të njohura nëpërmjet punësisimit të tij:

- a) e drejta për patentë për këtë shpikje i përket punëmarrësit, përveç rasteve, kur brenda një periudhe prej gjashtë muajsh nga data kur raporti, sipas shkronjës “b” të pikës 2 të këtij neni, i është paraqitur punëdhënësit, ose nga data kur punëdhënësi është njoftuar për shpikjen në mënyra të tjera, duke filluar nga data më e hershme prej këtyre datave, punëdhënësi njofton punëmarrësin nëpërmjet një deklarate me shkrim se është i interesuar për shpikjen;
- b) ky punëmarrës, që ka bërë shpikjen, në përputhje me shkronjën “a” të pikës 2 të këtij neni, duhet t’i paraqesë punëdhënësit menjëherë një raport me shkrim për shpikjen;
- c) nëse brenda periudhës së përcaktuar në shkronjën “a” të pikës 2 të këtij neni, punëdhënësi lëshon një deklaratë, ku shpreh interes për shpikjen, atëherë e drejta për patentë i përket punëdhënësit, që nga fillimi. Në varësi të pagës, vlerës ekonomike të shpikjes dhe fitimit, që punëdhënësi siguron nga shpikja, punëmarrësi ka të drejtën e kompensimit. Nëse palët nuk bien dakord për vlerën e kompensimit, ajo do të vendoset nga gjykata.

1.3. *Sa përqind e një fitimi të mundshëm i takon sipas legjislacionit shqiptar studiuesit dhe sa përqind institucionit që e ka financuar punën e tij mbi një patentë, shpikje apo inovacion të mundshëm që mund të komercializohet në treg? Cili akt ligjor apo nënligjor e përcakton këtë apo varet nga marrëveshja, kontrata e grantit mes tyre?*

Tek patentat për shpikje sipas Nenit 15 të Ligjit të Pronësisë Industriale.

1.4 *Cfarë procedurash ndjek Zyra Shqiptare e Patentave për të regjistruar si patentë shqiptare të një kërkuesi shqiptar një product të punës së tij kërkimore.*

Zyra shqyrton dosjen e ardhur sipas pikës 1.1 për datë depozitimi dhe lëshon Dëshminë e depozitimit.

Hapi i dytë, e shqyrton për formalitete dhe nxjerr njoftim nëse duhet për plotësime parregullsisht.

Hapi i tretë, pas plotësimit të dokumentacionit nxjerr ftesën për pagesë dhe më pas;

Lëshon Certifikatën “Patentë për shpikje”

1.5. *A mund të kërkojë një studiues apo kërkues shqiptar ta regjistrojë produktin e tij të punës kërkimore si patent, shpikje, inovacion, transferim teknologjie në një zyrë të huaj patentash pa kaluar më parë në Zyrën Shqiptare të Patentave.*

Po mund të kërkojë të aplikojë në një zyrë të huaj me përjashtim kur thuhet ndyshe nga neni 31.

1.6. *Sa aplikime për patent , shpikje , inovacion, kanë paraqitur kërkuesit shqiptarë deri tani pranë Drejtorisë së Pronësisë Intelektuale ? Sa është numri i tyre që janë regjistruar e njohur si patenta*

Statistikat:

Nga sistemi figurojnë gjithsej 144 patenta dhe modele perdorimi

*1.7. Cfarë dokumentacioni paraqet një studiues në këtë rast pranë Zyrës Shqiptare të Patentave dhe cilat janë pagesat e tarifave që duhet të paguajë një studiues shqiptar pranë Zyrës Shqiptare të Patentave për të realizuar procedurën e aplikimit e regjistrimit?*

Tarifat janë të përcaktuara në Vendimin Nr.883, datë 13.5.2009 "Për miratimin e tarifave për regjistrimin e objekteve të pronësisë industriale", i ndryshuar ku:

Tarifë për depozitim aplikimi për patentë 7000 lek

Tarifë për lëshimin e patentës 6000 lek

Për studentët, pensionistët, personat me aftësi të kufizuar, këto tarifa do të jenë 100 lek.

*II. Cila është baza ligjore (ligjet) dhe aktet nënligjore që rregullojnë marrëdhënien mes kërkuesit shkencor e institucionit që i financon punën kërkimore lidhur me produktin e tij kërkimor që mund të jetë artikull, monografi, artikull me bashkëautor?*

1. Patenta jepet për shpikje, në të gjitha fushat e teknologjisë, me kusht që:

a) të përbëjë risi;

b) të përmbajë hap shpikës;

c) të jetë e zbatueshme në industri.

2. Nuk vlerësohen shpikje, në kuptimin e pikës 1 të këtij neni, veçanërisht:

a) zbulimet, teoritë shkencore dhe metodat matematikore;

b) krijimet estetike;

c) skemat, rregullat dhe metodat për kryerjen e veprimeve mendore, për zhvillimin e lojërave dhe biznesit, si dhe programet kompjuterike;

ç) paraqitjet e informacionit

## **Pyetjet – përgjigjet për/nga Drejtoria e të Drejtave të Autorit (DDA)**

*1.1 Cfarë parashikon ligji shqiptar për të drejtën e autorit të kërkuesit mbi këtë material të shkruar lidhur me riprodhimin, botimin e tij të plotë në rastet kur ky produkt është financuar 100 % me para publike, pjesërisht apo financuar nga fonde të biznesit privat.*

- Bazuar në Ligjin për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me të Nr.35/2016, këtu e në vijim referuar LDA, parashikohet se vetem Autori ka të drejtë të vendosë se ku, kur edhe si do të përdoret vepra e tij, reference neni 21 i LDA-së.

Për sa i takon pjesës së financimit ligji përcakton qartë se ndërmjet porositesit / financuesit dhe autorit / kërkuesit duhet të nënshkruhet paraprakisht kontrata e cila detyrimisht duhet të përmbajë llojin e të drejtave ekskluzive apo jo ekskluzive, territorin e shfrytëzimit Shqipëri apo edhe jashtë saj, afatin e shfrytëzimit si edhe të drejtat dhe detyrimet në të cilat përcaktohet se si do të ndahet shpërblimi duke marrë parasysh politikat e Institucionit kërkues të këtij studimi. Referencë nenet 45, 59, 67, 69 te LDA-se.

*1.2. Cila është baza ligjore që parashikon procedurën e një afati të së drejtës së autorit mbi një*

*material të shkruar shkencor (artikull, monografi) lidhur me riprodhimin apo ofrimin e tij si open access nga institucione apo individë (psh 10 vjet apo më shumë).*

-Bazuar në përcaktimet e LDA përkaësisht nenet 67 dhe 69 përcaktojnë kontratën e porosisë dhe kontratën e punës, ku si kriter kryesor përcaktohet qëllimi porosisë për veprën, dhe afati lihet në dorë të palëve në varësi të qëllimeve për të cilat do të përdoret vepra. Në rastin e kontratës së punës të drejtat pasurore i takojnë punëdhënësit për 3 vjet nga krijimi dhe dorëzimi i veprës në çdo rast me përjashtim kur në kontratë është përcaktuar ndryshe, për sa i përket pjesës kur punëmarrësi mund të largohet nga puna të drejtat pasurore i kthehen autorit vetëm pas mbarimit të afatit të kontratës. Pra për cdo rast ka rëndësi fakti i shprehjes së vullnetit të palëve.

*1.3 Cili është institucioni që duhet ti drejtohet një studiues shqiptar kur është shkelur e drejta e tij mbi pronësinë intelektuale apo të drejtën e autorit.*

- Cdo krijues paraprakisht duhet të provoj që është autor i veprës origjinale paraprakisht, pra duhet të mbahet parasysh nga cdo krijues mënyra e të provuarit nga momenti që krijohet një vepër. Institucionet që Krijuesit duhet ti Drejtohen janë: Gjykata e Rrethit, ku si palë të tretë në rolin e ekspertit mund të kërkojë edhe prezencën e Drejtorisë së të Drejtave të Autorit dhe të drejtave të tjera të lidhura me të si edhe Inspektoriatit Shtetëror të Mbikqyrjes së Tregut, Institucion pranë Ministrisë së Ekonomisë. Për raste kur vepra mund të jetë përdorur në Radio edhe Televizione ankesa mund t'i drejtohet edhe Autoritetit të Mediave Audiovizive.